REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Nr.825 prot. Durrës më 30/03/2021

URDHËR

Nr.13, Datë 30/03/2021

"PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË RISHIKUAR TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME DETARE"

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit"

URDHËROJ

1. Miratimin e Programit të Transparencës të Drejtorisë së Pergjithshme Detare sipas formës dhe përmbajtjes së miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), me urdhërin me nr.187, datë 18.12.2020 "Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar".
2. Programi i Transparencës së DPD-së ka përmbajtjen sipas aneksit bashkëlidhur dhe publikohet në faqen zyrtare www.dpdetare.gov.al në menunë "Programi i Transparencës".
3. Ngarkohen të gjithë sektorët dhe koordinatori për të drejtën e informimit për të bashkërenduar punën për bërjen publike sa herë që është e domosdoshme të çdo dokumenti në funksion të programit të transparencës së rishikuar.
4. Programi i Transparencës së DPD-së miratuar me Urdhërin nr.82, datë 27.02.2016 shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

PAVLIN NDREU

Programi i Transparencës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare

1. Hyrje



Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur programi i transparencës për Drejtorinë e Përgjithshme Detare. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit"(LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. DPD-ja do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së DPD-së, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.dpdetare.gov.al si dhe në mjediset e prijtjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e DPD-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

2. Rreth Autoritetit



- Vendimi-Miratuar/Struktura
- Struktura e pagave
- Funksionet dhe detyrat e DPD
- CV-të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të DPD, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre
- Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të DPD për të marrë vendime
- Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e DPD (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave – Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve)

3. Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi DPD



- Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë (nëse ka të tillë)
- Planet strategjike të punës
- Raporte monitorimi/auditimi (p.sh:KLSH)
- Dokumente të tjera që përmbajnë treguesit të performancës së DPD

4. Shërbimet që ofrohen nga DPD



Lista e Shërbimeve* që ofron DPD, përfshirë

- Shërbimet
- Kartela Informative

Shënim: Lëshim dokumentacioni/Leje/Licenca/Autorizime etje.

5. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve



- Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar (sipas Modelit të Regjistrit të miratuar nga Komisioneri)

6. Kuadri ligjor rregullator, Tekstet e plota



- Aderim në Konventa dhe Marrëveshje Ndërkombëtare
- Legjislacion kombëtar
- Rregullore
- Vendime të KM dhe Udhëzimet, Urdhërat
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit
- Strategji
- Raport vjetor

7. Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të DPD



8. Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të DPD



9. Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga DPD



- Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga DPD
- Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve
- Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim
- Procedura e ankimimit
- Kërkesat dhe përgjigjet (të linkuara për DPD që nuk kanë instaluar portalin Pyet Shtetin/Portali Pyet Shtetin i përditësuar me kërkesat dhe përgjigjet

10. E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar



- Koordinatori:
  - Henri Hasani
- E-mail:
  - info@dpdetare.gov.al
  - henri.hasani@dpdetare.gov.al
- Nr. i gjelbër
- Tel
- Adresa:
  - Lagjia nr.1 Rruga Tregtare Durrës
- Orari
  - E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30
  - E premte: 08:00 – 14:00
- Format kërkese / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)
- Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri)

11. Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat



- Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik
- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik
- Informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme

12. Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve



- Lista e dokumenteve që administrohen nga DPD me afatet e ruajtjes
- Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)

13. Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga DPD



- Njoftime të ndryshme
- Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimit në shërbim civil
- Raporte
- Publikime
- Statistika
- Projekte
- Bashkëpunime

Shënim: DPD vlerëson publikimin duke patur parasysh kërkesat që merr më shpesh.